



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Pukë, më , 12.02. 2026

Nr. 171/2 prot

VENDIM

Nr. 03 datë 11.02. 2026

**“ PËR
PËRCAKTIM PËRDORIM FONDI (GRANT PËRFORMANCE), ME BURIM FINANCIMI I
HUAJ”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015" Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", udhëzimet e përbashkëta, të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendorë numër 20, dhe 01, datë.11.07.2025 "Për kriteret ,procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025", në shkresën e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nr.764 prot, datë.19.12.2025 "Shkresë përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të KVA-së në kuadër të GBP 2025", Këshilli i Bashkisë Pukë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë;

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të grantit të performancës me burim financimi i huaj si më poshtë:
 - a- Shuma e grantit për përdorim është 7.666.543 (shtatë milion gjashtëqindë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqindë e dyzet e tre) lekë
 - b- Ky fond të përdoret për shpenzime kapitale, në llogarinë ekonomike 231, me kapitull 02 (financim i huaji), në strukturën Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore, Kod Programi 08220 për në Bashkinë Pukë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore", neni 55, pika 6.
4. Vendimi u shpall me date **12. 02.2026**
Vota te vlefshme gjithsej 9
Vota pro 9 , Vota kunder 0 , Vota abstenim 0

SEKRETARI
Hazbi Terbuni

KRYETARI
Gjon GJOKA



27.02.26

H. Te detyr
F. laktito
per ufaq
c2 sety
refuz



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

142/1
Nr. prot.

Shkodër, më 25.02.2026



LËNDA: Mbi vendimin Nr.3 datë 11.02.2026 të Këshillit të Bashkisë Puke.

KËSHILLIT TË BASHKISË PUKE

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji Nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin” i ndryshuar, neni 56 i KPAD, Urdhërit të Kryeministrit Nr.21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të MB Nr.39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, në mbështetje të nenit 54/dh, nenit 55/3, neni 64/c të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit Nr.9936 dat.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetore në RSH” i ndryshuar, Ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, VKB Puke Nr.43/2025 “Miratim buxheti 2026 dhe PBA”, Dokumentacionit të dërguar nga Sekretari Këshillit Bashkiak Puke Nr.213/4prot datë.12.02.2026, Shqyrtoi **VKB Pukë nr.3 datë 11.02.2026 Puke** “Për detajim fondit 7.666.543 lekë, grand performance, sipas shkresës së MF Nr.18133/1prot date.24.12.2025 dhe shkresës së AMVV Nr.764prot date.19.12.2025, me objekt “Rikonstruksion Pallati i Kulturës Ndue Shyti”. Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

